

VENDIM
Nr. 750, datë 1.12.2022

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2023, në shumën 381 500 000 (treqind e tetëdhjetë e një milionë e pesëqind mijë lekë), sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Pasqyra nr. 1

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
DHE POSTARE, PËR VITIN 2023**

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	159,000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	117,800
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	126,000	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15,600
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	6,550
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	19,400	Shpenzime për shërbime	163,406
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	9,500	Shpenzime për investime	78,144
Të ardhura nga pagesa për <i>domain</i>	6,900		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	200		
Të ardhura nga komisioni nga agjenti tatimor	24,500		
Total i të ardhurave	381,500	Totali shpenzimeve	381,500